

**Dr. Dorian Koçi**

Drejtor i Muzeut Historik Kombëtar

## **TRANZICIONI KULTUROR NË SHQIPËRINË E KAPËRCYELLIT TË VITEVE '90**

Studimet mbi tranzicionin dhe ndryshimet politike që përfshinë Evropën Juglindore në kapërcyellin e viteve 90' janë fokusuar kryesisht në vektorët politikë dhe ekonomikë, duke lënë paksa mënjanë vektorin kulturor dhe përfshirjen e elementëve kulturorë në këto transformime politike të rëndësishme që shënuan rënien e komunizmit dhe triumfin e demokracisë liberale. Shqipëria dhe rasti shqiptar nuk bënë përjashtim nga kjo përjasje analitike ndaj tranzicionit në Evropën Juglindore, por duke qenë se rasti i saj është më specifik se shtetet e tjera të ish kampit socialist, analizimi i vektorit kulturor meriton një vëmendje të veçantë. *Studimi mbi fushën e kulturës dhe të ligjësisë tregon se në shoqërinë qytetare marrëdhënia mes moralit dhe zgjedhjeve individuale dhe norma prodhon shumë më shumë sugjerime për t'i përkthyer në ligje dhe programe politike.*<sup>1</sup> Tranzicioni politik

---

<sup>1</sup> Pardo. I. 2001, *Elita senza fiducia. Ideologie, etiche di potere, legittimita*. Catanzaro, Rubbetino Editore, fq 13.

në Shqipëri i filluar në dhjetor 1990 me pranimin e pluralizmit politik e ka një histori dhe eksperincë të filluar së pari në shndrrimin e kulturës shqiptare në një katalizator të ndryshimeve në vend.

Në mesin e viteve 80', vdekja e diktatorit Hoxha tronditi shtetin e atrofizuar socialist dhe institucionet e tij kryesore që fillimisht ishin krijuar kinse për të “revolucionarizimin e shoqërisë”, tashmë u gjendën para sfidës për tu shndrruar në mburojë për të ruajtur statukuon politike dhe jetëgjatësinë e regjimit. Shteti komunist shqiptar nuk u gjet para një krize për të zgjedhur pasardhësin por para një sfide tjetër morale. Totalitarizmi komunist shqiptar që ishte përgjegjës për izolimin e skajshëm të vendit, tashmë i duhej të kalonte nga një totalitarizëm i diktaturës personale të Enver Hoxhës në diktaturën partiake ose oligarginë partiake. *Pas vdekjes së diktatorit Hoxha më 1985, të njëtin kurs ndoqi edhe pasardhësi i tij Ramiz Alia, i cili pothuajse nuk bëri asgjë për të nxjerrë vendin nga izolimi, përkundrazi u përpoq të ndërthurte brenda sistemit të ri, një kopje të shëmtuar të perestrojkës, me ca elementë regjimesh të tjera po aq shtypës sa edhe ai shqiptar.*<sup>2</sup>

Ky ndryshim politik nuk ishte se po eksperimentohej përherë të parënë Shqipëri. Për shkak të izolimit të plotë të Shqipërisë që nuk kishte marrë pjesë plotësisht në procesin e destalinizimit që ndodhin në mesin e viteve 50' në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore dhe as në lëvizjet e tjera reformuese të socializmit çek me fytyrë njeriu, ndaj përpjekjet e para për të liberalizuar pushtetin komunist do t'u përngjanin më tepër periudhës së shkrirjeve të akujve në mesin e viteve

---

<sup>2</sup> Tafili Hyskaj, E. Tranzicioni politik në Evropën Qendror edhe Lindore. SHBLU: Tiranë: 2008, fq 113.

50' në Bashkimin Sovjetik. Tridhjet vjet më parë, vdekja e Stalinit në Bashkimin Sovjetik kishte shkaktuar të njëjtat reagime pasigurie për të ardhmen në udhëheqjen partiake sovjetike, njëlloj si në udhëheqjen shqiptare në mesin e viteve 80'. Edhe pse të dy ngjarjet i ndante një hark kohor pak më shumë se tridhjet vjet, ngjashmëritë e sistemeve të shpallura prej vet ndërtuesit të totalitarizmit shqiptar Enver Hoxhës me stalinizmin si rrymë mendimi dhe model qeverisje ishin të dukshme. Në librin e vet me kujtime “Me Stalinin”, Enver Hoxha shkruante se *partia dhe populli ynë do të vazhdojnë rrugën e Karl Marksit, të Frederik Englesit, të Vladimir Ulianov Leninit e të Josif Stalinit. Brezat e ardhshëm do të ndjekin me besnikëri vijën e Partisë së tyre të shtrenjtë. Shqiptarët, komunistë e patriotë të pa parti përulën me respekt përpara kujtimit të mësuesit të lavdishëm, Josif Stalinit.*<sup>3</sup>

Regjimi komunist shqiptar ashtu si Hrushovi në mesin e viteve 50' në Bashkimin Sovjetik do t'i fillonte një pjesë të reformave të veta për të liberalizuar kontrollin total të Partisë së Punës së Shqipërisë në jetën e vendit dhe strukturave ekonomike duke inkurajuar në fillim lirinë kulturore. Gjithsesi në këtë përjasje të re të regjimit ndaj liberalizmit kishte në sfond një dallim thelbësor. Nëse Hrushovi në mesin e viteve 50' e kishte ndërmarrë këtë hap edhe si një refuzim i vazhdimësisë totalitare të Stalinit, Ramiz Alia ishte i detyruar nga sfondi politiko-ekonomik i vendit dhe Evropës Lindore. *Hrushovi autorizoi hapjen e ekspozitës së parë të artit modern perëndimor që nuk kishte asnjë lidhje me metodën zyrtare të “realizmit socialist” që zbatohet në Bashkimin Sovjetik. Në vitin 1962 ai lejoi publikimin e veprës së Aleksandër Solzhenicinit “Një ditë nga jeta e Ivan Denisoviçit”, ndoshta*

---

<sup>3</sup> Hoxha, E, 1979, Me Stalini, Shtëpia botuese “8 nëntori”, Tiranë, f.39

*për të ulur figurën e Stalinit.*<sup>4</sup> Sigurisht në Shqipëri nuk pati një zhvillim të tillë dhe figura e Enver Hoxhës do të kontestohet në publik disa vite më vonë nga Partia e parë opozitare dhe në qershor 1991 nga një nga themeluesit e Partisë Socialiste, shkrimtari Dritëro Agolli, por era e një ndryshimi dhe liberalizmi filloi të ndihej sidomos pa vitit 1987.

Në përgjithësi niveli i debateve dhe mospajtueshmëria e kësaj ere liberalizmi që po frynte me dogmën mbizotëruese zyrtare të komunizmit në Shqipëri nuk është se krijoi një situatë tensioni në shoqëri apo u nxit një debat mbi fillimin e reformave pasi në Shqipëri gjatë regjimit komunist ka egzistuar një reflektim tejet i kufizuar filozofik, me kuptimin e mirrëfilltë, mbi marksizmin si doktrinë dhe mbi etikën marksiste. Madje mund të thuhet se edhe qendrimet politike që ishin imponuar në kulturë nuk është se rridhnin kryesisht prej etikës marksiste, por shpesh herë ishin zgjedhur sipas interesave kunjukturale të udhëheqjes komuniste shqiptare për të përforcuar totalitarizmin në çdo qelizë të jetës sociale të shqiptarëve. Dy divorcet e ndryshme politike të Partisë së Punës së Shqipërisë së pari me Bashkimin Sovjetik, mu bash në hapjen dhe liberalizmin kulturor përkundrejt Perëndimit dhe adaptimi i principeve të Revolucionit Kulturor Kinez në mes të viteve 60' lanë gjurmët e tyre të thella në kulturën shqiptare. Në Shqipëri artistët dhe kultura shqiptare i nënshtroheshin doktrinës së Realizmit Socialist. Parimet e kësaj doktrine përmbanin një sërë detyrimesh, si: 1) veprat duhet të ishin realiste në përmbajtje dhe në formë; 2) ato duhet të kishin apelin e masave; 3) mesazhi i tyre duhet të ishte kurdoherë optimist; 4) duhet t'i përmbaheshin vijës së partisë.<sup>5</sup>

---

<sup>4</sup>Filo.Ll. Sistemetpolitikebashkëkohore.BotimetIdeart:Tiranë, fq 375

<sup>5</sup> Po aty, fq 381

Një nga objektivat kryesore të kulturës së shtetit socialist shqiptar e lidhur ngushtë me doktrinën e Realizmit Socialist ishte ndërtimi i Njeriut të Ri, një term i huazuar nga kultura sovjetike e që për më tepër se tridhjetë vjet mbizotëroi në ligjërimin publik shqiptar. Në revistën ‘Rruga e Partisë’ që ishte një botim i Institutit të Studimeve Marksiste Leniniste në artikullin “Probleme të zhvillimit të kulturës sonë socialiste” të autorit Ismail Hoxha, shkruhej se *baza ideologjike e kulturës sonë socialiste ka qenë dhe është rruga marksiste-leniniste e partisë sonë, e mbi këtë bazë , kultura jonë duhet të ndihmojë përherë dhe me efikasitet të lartë dhe pa ndërprerje:së pari, në formimin shumëdimensional të njeriut të ri dhe të shoqërisë sonë të re , duke i brumosur ata me ideale të thella e me bindje marksiste leniniste, me veti të larta morale dhe me një horizont të gjerë kulturor dhe një botë kulturore të pasur.*<sup>6</sup>

Në këtë mënyrë kultura socialiste ishte një kulturë që mbartte brenda vetes misionin mesianik të shpëtimit të njeriut dhe brumosjes së tij me idealet e marksizëm-leninizmit duke krijuar premisa krejt të kundërta nga atë çka kultura në vetvete përfaqëson sipas Branislaë Malinoëski se kultura është ajo tërësi integrale që konsiston në mjete, sende të konsumit, në normat e së drejtës për grupe të ndryshme sociale, në idetë dhe mjeshtëritë njerëzore, në besime e zakone. Në regjimin komunist ishte tentuar që besimet e zakonet e rrënjosura prej kohësh të çfuqizoheshin në shërbim të idealit epuvretë të Njeriut të Ri. Në mënyrë të paprecendetë ishte ndërprerë edhe lidhja me kulturën e mëparshme shqiptare pasi ashtu si lindja nga një familje proletare, siguronte një pozicion të privilegjuar

---

<sup>6</sup>Nikolla.P.A. Njeriu I ri shqiptar. Ndërmjet moralit komunist dhe krizës së tranzicionit. Onufri. Tiranë:2012, fq 66

në hierarkinë sociale post revolucionare<sup>7</sup>, i njëjti kriter ishte i vlefshëm edhe për shkrimtarët e së shkuarës. Kjo shkëputje dhe ndërprerje me traditën kishte sjellë konceptimin e artit dhe kulturës si një instrument të vënë në shërbim të ideologjisë. *Arti vihet në shërbim të masave të gjera popullore dhe shndërrohet në një armë të fuqishme të edukimit estetik, të edukimit komunist, të përhapjes në shoqëri të idealeve më të larta social-estetike, të idealeve komuniste.*<sup>8</sup>

Si shikohet Partia e Punës së Shqipërisë kontrollonte gjithë jetën publike në Shqipëri, përfshi dhe artin dhe kulturën duke synuar një nga parimet kryesore të tyre, individualizmin tija nënshtronte kolektivizmit dhe heroit skematik që sakrifikohej në emër të idealeve dhe socializmit. Në këtë kontekst thyerja e tabuve të artit dhe kulturës të Realizmit Socialist konsiderohej si një herezi e madhe, çka sillte dhe represione nga aparati i dhunës si kish qenë mesi i viteve 70' me Plenumin e IV të Komitetit Qendror, ku Enver Hoxha kishte dënuar personalisht të ashtëquajturat prirje borgjezo-revizioniste në art. Gjithsesi procesi i Perestrojkës dhe Glasnostit që u ndërmorr nga Gorbaçovi në vitet 1985-1986, procese që synonin rikonstruktimin ekonomik dhe transparencës në qeverisje sollën dhe një liberalizëm në kulturën sovjetike por edhe një impakt në vendet e kampit socialist. Shqipëria edhe pse prej mëse se 25 vjet ishte shkëputur politikisht nga Bashkimi Sovjetik dhe vendet e kampit socialist, si është provuar gjerësisht ekonomikisht vazhdonte të ishte një apendiks i KNER. Në këtë kontekst ndryshimet e mundshme në Bashkimin Sovjetik dhe vendet e Evropës lindore do të

---

<sup>7</sup>Nikolla. P. A. Njeriu I ri shqiptar. Ndërmjet moralit komunist dhe krizës së tranzicionit. Onufri. Tiranë:2012, fq 67

<sup>8</sup> Uçi. A. Estetika, vëll 3. SHBLU, Tiranë, 1989, f.109

kishin një efekt zinxhir edhe në Shqipëri. Ashtu si më herët në Bashkimin Sovjetik gjatë kohës së Hrushovit por edhe nën shembullin e tolerancës dhe lirisë kulturore që ushtroi Gorbaçovi në vitet 1986-1991, udhëheqja shqiptare filloi liberalizmin e regjimit në vektorin kulturor. Kjo zgjedhje mendoj se nuk ishte e rastësishme. Disa faktorë që kanë influencuar në marrjen e këtij vendimi mendoj se kanë qënë fakti se duke qënë se udhëheqja komuniste besonte në dogmën e marksizmit dëshironte që ndryshimet ekonomike që përbënin dhe zemrën e ideologjisë të ishin një retushim i lehtë pa shkuar në pranimin e ekonomisë së tregut. E lidhur ngushtë me adaptimin e ndryshimeve të thella në ekonomi , ishin dhe ndryshimet në politikën e brendshme, ndryshimeve që udhëheqja e kohës i trembej t'i ndërmerre sepse humbiste monopolin politik. Së fundi, nëpërmjet propagandës dhe kontrollit që i kish bërë zhvillimit të artit dhe kulturës, udhëheqja politike shqiptare mendonte se do të mund t'i kontrollonte këto ndryshime duke mos shkuar shumë larg.

Në vitin 1987, dy këngëtarë të njohur të muzikës italiane Albano Karrizi dhe Romina Power dhanë një koncert në Pallatin e Kongreseve me këngë italiane kryesisht të rrymës rok, rrymë muzikore e cila kishte qënë e ndaluar në Shqipëri dhe këngëtarë shqiptarë që ishin përpjekur të performonin në këtë rrymë muzikore ishin arrestuar e burgosur. Koncerti i dy këngëtarëve italianë që thyen një tabu përse i përket shijeve estetike të imponuara me forcë nga kultura shtetërore tregoi një realitet tjetër përse i përket mobilizimit estetik ndaj së bukurës dhe përqafimit të bashkohores në art. Në këtë mënyrë imazhet televizive të para nga kanalet e Rai, që influeconte shumë në Shqipëri, u përjetuan si të vërteta.

Në vitin 1987, pas një sorollatje të gjatë nëpër zyrat e shtetit, u botua romani i shkrimtarit Ismail Kadare 'koncert

në fund të dimrit”, ku autori bënte një autopsi të komunizmit kinez, korrente të të cilit kishin fryrë dhe në Shqipëri. Për lexues të kualifikuar nuk ishte e vështirë të kuptoje përmes faqeve të tij aparatit e dhunës si dhe represionin në jetën e përditshme të qytetarëve të thjeshtë. Në vepër mungonte një personazh kryesor pozitiv që përçonte një mesazh pozitiv për të ardhmen. Romani mbyllet me personazhin e plakës Hasije që ngatërron pushtuesit osmanë me kinezët duke lëshuar një alegori të fortë se Shqipëria kish qenë e mbetej e përherëshme dhe jo ideologjitë që vinin e iknin. Për më tepër për herë të parë në një vepër artistike hidhej dritë mbi anën njerzore të ngjarjeve të përgjakshme të të ashtëquajturit puç ushtarak në vitin 1974, tema tabu për opinionin shqiptar të kohës që ishte i detyruar të lexonte vetëm variantin politik në orët e gjata të edukimit politik.

Në vitin 1989, shkrimtari Petro Marko, të cilit i ishte hequr e drejta për botim dhe i biri kishte bërë burg politik, u lejuua të botojë romanin “Nata e Ustikës”. Romani “Nata e Ustikës” edhe pse trajtonte temën e antifashizmit dhe ngjarjeve në Luftën e Dytë Botërore, ishte i veçantë nga metoda e Realizmit Socialist. Në roman, personazhi kryesor Andrea, një i ri shqiptar komunist është mbi të gjitha një genie njerzore që ka frikë nga vdekja dhe që në dashurinë etij të pafat me Sonjën nuk përcjell optimizmin e kërkuar nga një vepër e Realizmit Socialist.

Shembujt e mësipërm , gjithsesi nuk dëshmojnë se ndryshimet dhe liberalizimi në kulturë ishte i thellë deri në atë shkallë sa të rehabilitoheshin shkrimtarë të së shkuarës që kishin qenë të anatemuar nga regjimi komunist. Në esenë e gjatë të Ismail Kadaresë ‘Ardhja e Migjenit në letërsinë shqipe’, shkruar në vitin 1989 e botuar në vitin 1991, Gjergj Fishta , një nga shkrimtarët e klerit katolik sërish kritikohet duke i mohuar vlerat letrare.Përpyekja e tij për të shkruar

“Lahutën e Malsisë”, Kadare e quante si të dështuar për shkak *se poetit franceskan i mungonin shumë gjëra, e në radhë të parë ai talent i veçantë për të përpunuar, apo më saktë për të vënë nën fre, atë shkumëzim të lirë, magjepës e me bukuri befasuese, herë parajsore e herë inferiale të eposit verior*<sup>9</sup>. Shijet dhe kritika letrare, gjithsesi mund të ishin të pranueshme për të gjykuar një vepër letrare por emri kolektiv, *shkrimtarët reaksionarë veriorë*<sup>10</sup> kur i referohej Fishtës dhe Koliqit, dallohej lehtë që ishte një ndikim i ideologjisë komuniste.

Në përgjithësi regjimi komunist nëpërmjet hierarkëve më të lartë në kulturë, pjesa më e madhe e të cilëve ishin prohim i drejtë për së drejtë i shkollave sovjetike dhe atyre kuadrove të krijuar gjatë të ashtëquajturit revolucionit tekniko-shkencor, një përpjekje mjerane komunizmit shqiptar për t’iu kundërvënë revolucionit hi tech dhe dijeve të thelluara në Perëndim, u përpoq që të ringjallte një frymë liberalizimi të kontrolluar përmes levave dhe forumeve të Partisë së Punës. Në këtë kontekst koncepti i kritikës së drejtë dhe autokritikës i zhvilluar rreth viteve 70’ nga Hoxha u rrimor sërish në formën e pluralizmit të mendimeve për t’ia kundërvënë konceptit të pluralizmit politik që do të sillte dhe ndryshimin e sistemit monopartiak. Në këtë kohë kemi edhe inflancionin e termit intelektualë që do të luante një rol të rëndësishëm në ligjërimin publik shqiptar gjatë tranzicionit. Regjimi komunist e nënvlerësoi rolin e kulturës dhe aftësive të saj për të mobilizuar një mesazh të ndryshëm nga ai zyrtari. Janë të paktën dy raste ku vektori kulturor përshpejtoi ndryshimet politike dhe ekonomike të shumë pritura në Shqipëri.

---

<sup>9</sup> Kadare. I. Ardhja e Migjenit në letërsinë shqipe. Shtëpia Botuese 8 nëntori: Tiranë, 1991, fq 40

<sup>10</sup> Po aty, fq 39.

Do të ishte një tubim në sallën e Institutit të lartë të Arteve në datën 8 dhjetor 1990 në përkujtim të vrasjes së Xhon Lenon, një simboli kulturor të viteve 70-80 që do shënonte protestën e parë të studentëve shqiptarë për të zyrtarizuar pluralizmin në Shqipëri. Ja si e kujton një nga organizatorët e tij Ardian Klosi në librin e vet “Refleksione”. *Mbrëmja ishte në delir , që filloi normalisht, siç fillonin bisedat e mia të zakonshme. Në radhën e parë të të ftuarve ishin ulur miq dhe kolegë të brezit tim, që për çudi kishin një ngrirje referati, e cila nuk shkriu as kur studentët prapa tyre shungulluan koret më të egra dhe më të bukura që mund të ketë nxjerrë kjo tokë, që nga koha kur turqit janë thyer për herë të parë përpara krujës. Ndërsa nga altorpalantët ushtonte Revolution, dhe përktheheshin vargjet; Nëqoftëse ti vazhdon të mbash portretet e Kryetarit Mao, s’ke për të bërë asgjë me askën, dhjetëra duar studentësh ngritën lart pllakatin me fytyrën e Xhon Lenonit dhe e lëkundën atë përpara portretit buzagaz të Sekretarit që po i lëkundej toka nën këmbë. Edhe njëherë, edhe një herë”, bërtisnin pas Poëer to the people dhe ngrinin lart dy gishtat V, atë simbol që do zyrtarizohej aq shpejt.*<sup>11</sup>

Po kështu ikja e Ismail Kadaresë në Francë në tetor të vitit 1990 e vendosi shtetin shqiptar në situatën kur një nga përfaqësuesit e letërsisë së Realizmit Socialist do të duhej ose ti ndalohej vepra dhe të shpallej armik. Situata ishte e ngjashme me dënimin e Pasternakut në Bashkimin Sovjetik në 1958 pas marrjes së çmimit Nobel, por nëse Pasternaku në kuadër të Luftës së Ftohtë nuk mund të shërbente si model për të inspiruar ndryshime politike, ikja e Kadaresë bash në momentin kur diskutohej ideja e pranimit të pluralizmit politik, ishte një shembull që përpshpejtoi disa nga ndryshimet

---

<sup>11</sup> Klosi, A, Rama. E. Refleksione. Botime Albania: 1992, Tiranë, fq 23

ppolitike të pritshme. Shteti komunist në një deklaratë të thatë nënvizoi faktin se Ismail Kadare kishte dezertuar e tradhëtuar kauzën e socializmit por vepra e tij nuk u ndalua nga qarkullimi.

Tranzicioni në kulturë synonte në radhë të parë anulimin e dogmës dhe kanoneve të artit e kulturës së Realizmit socialist dhe zgjatimin e kësaj kulture, heroi pozitiv të njeriut të ri. Kjo qasje e re sigurisht që do të kalonte përmes përqaftimit të shumë rrymave në art e kulturë dhe në mënyrë të vetvedijshme do përforconte lirinë personale të krijuesve, e cila nga ana e vet do të përkthehej në një liri më të madhe transmetuar audiencës. Vitet e para 90' janë të mbushura me eksperimentime në art e kulturëe përkthime të shumëllojshme nga tradita më e mirë moderne botërore, por çuditërisht, në vend që kjo kulturë e re të krijonte një etikë të re , për fat të keq vazhdon ende të mizotërojë konture të rëndësishme të vektorit kulturor të ndërtuar që në diktaturë. Trancizicioni në Evropën Qendrore dhe Lindore(përfshi dhe Shqipërinë) në nivel politik ka përparuar në mënyrë tejet të ndryshme nga ajo që na lë të kuptojmë modeli klasik i tranzicionit; nëse krahasonim me demokratizimin e shoqërive perëndimore, në periudhën 1860-1920. Ky model ka të bëjë me zgjerim në rritje të të zbatimit të praktikave demokratike, pasi eksperiencia e Evropës Qendrore dhe Lindore pasqyron ndryshime pjesërisht të papritura me këtë dukuri. Në Evropën Perëndimore demokratizimi u krye në favor të klasave të caktuara , ndërsa në Evropën Qendrore dhe Lindore ndodhi e kundërta: nga ndryshimet e kryera përgjatë tranzicionit përfitoi apo po përfiton një elitë e caktuar. <sup>12</sup>

---

<sup>12</sup>Tafili Hyskaj, E. Tranzicioni politik në Evropën Qendrore dhe Lindore. SHBLU: Tiranë: 2008, fq 25

Kjo elitë nuk është vetëm politike dhe ekonomike por edhe kulturore. Në tekstet zyrtare të shkollave, historitë e arti dhe kulturës shqiptare përfaqësuesit më të denjë vazhdojnë të jenë elita kulturore e formuar në socializëm. Nëse në fillim të viteve 90' përfaqësuesit më të denjë të kësaj elite arritën që nëpërmjet mistifikimit të lirisë personale të përgatisnin terrenin për një tranzicion të mundshëm të shoqërisë shqiptare nga socializmi e totalitarizmi drejt ekonomisë së tregut dhe individualizmit të spikatur të vlerave, tashmë nuk mund të mbajnë më mbi supe procesin ende të paformuar të një etike të re kulturore. *Boshllëku që lë modeli i etikës marksiste ka krijuar elementët paraprake për një model të etikës ulitariste në variantin e theksuar të edonizmit , sepse për të pasur një model tjetër etik( përshembull etikës personale) shërben një përgatitje kulturore shumë e gjatë dhe një kulturë e promovimit të dinjitetit njerëzor, që sot mungon.*<sup>13</sup>

Mungesa e kësaj kulture dominuese për të inspiruar dhe përfaqësuar brezat e rinj të shqiptarëve është vërtetë dëshpëruese dhe ka lënë një boshllëk të madh , aq sa në ligjerimin publik madje dhe në nivel të lartë të administratës shtetërore përdoren ende simbole e personazhe kulturore të së shkuarës. Shqipëria ende vazhdon të mbetet e panjohur në botë dhe ka probleme me imazhin e saj kulturor si vend pasi nuk ka arritur në këto 25 vite të sendërtojë paradigma të tjera kulturore të veçanta dhe individuale përpos atyre që trashëgoi nga diktatura. Për fat të keq mungojnë analiza të plota dhe shterruese për të parë efektet e sistemit totalitar komunist mbi shqiptarët. *Diktatura e partisë-shtet dhe ekonomia e planifikuar nuk duhen harruar, ashtu si nuk duhet lënë në*

---

<sup>13</sup>Nikolla. P. A. Njeriu I ri shqiptar. Ndërmjet moralit komunist dhe krizës së tranzicionit. Onufri. Tiranë: 2012, fq. 147-148.

*harresë fakti që komunizmi ka ndikuar tejmasë në praktikat shoqërore, duke skematizuar mënyrën e të vepruarit, çka do të thotë që transformimet shoqërore në Evropën Qendrore dhe lindore varen jo vetëm nga përmbushja e objektivave të marrë përsipër për të realizuar, por në tënjëjtën kohë edhe nga ndryshimi i botëkuptimit.*<sup>14</sup>

Sfida më e madhe e kulturës shqiptare mbetet pikërisht në ndryshimin e këtij botëkuptimi sigurisht jo duke krijuar në vend tënjëriut të ri, njeriun pragmatik, i aftë për të kryer kompromiset më të mëdha dhe për të përfutur më shumë në kurritë shoqërisë, por të nxisë hierarkinë e vlerave kulturore të nevojshme për të krijuar një etikë morale integruese me kombet e tjera në Evropë.

### **Bibliografi:**

1- Filo.Ll. Sistemet politike bashkëkohore. Botimet Ideart:Tiranë

2- Hoxha, E, 1979, Me Stalinin, Shtëpia botuese “8 nëntori”, Tiranë

3- Kadare .I. Ardhja e Migjenit në letërsinë shqipe. Shtëpia Botuese 8 nëntori:Tiranë, 1991

4- Klosi.A, Rama.E. Refleksione. Botime Albania:1992, Tiranë

5- Nikolla.P.A. Njeriu I ri shqiptar.Ndërmjet moralit komunist dhe krizës së tranzicionit.Onufri. Tiranë:2012

6- Pardo. I. 2001, Elita senza fiducia. Ideologie, etiche di potere, legittimita. Catanzaro, Rubbetino Editore

7- Uçi.A.Estetika, vëll 3. SHBLU, Tiranë, 1989

---

<sup>14</sup>Tafili Hyskaj, E. Tranzicioni politik në Evropën Qendrore dhe Lindore. SHBLU: Tiranë: 2008, fq. 23.